



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-140
19.4.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 2 nga neni i njëjtë i Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, dhe 55/24), neni 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15) dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-140 datë 17.4.2024, për marrjen e vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802 - 89 datë 15.3.2024, për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.67/24), në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1926/2 datë 18.4.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 17- të mbajtur më 18.4.2024 miratoi:

VENDIM

1. **Anulohet** Vendimi, PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023.

2. **DETYROHET** SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, më së voni deri më 26.4.2024, të përmbush detyrimet e mëposhtme financiare dhe të tjera, përkatësisht:

- të paguajë shpenzimet në vlerë prej 3.287,00 denarë me TVSH për publikimin e Vendimit për heqjen e lejes për radiotransmetim PA1 nr.0802-89, datë 15.3.2024 në ("Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 67/24) - sipas faturës nr.3050-6849/27 datë 27 3.2024 (nr.y në ark.05-1528/1, datë 28.3.2024);
- të paguajë shpenzimet në vlerë prej 3.287,00 denarë me TVSH, për publikimin e këtij Vendimi për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes për radiotransmetim PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 në Gazetën Zyrtare të RMV-së;
- për tërheqjen e padisë së paraqitur para Gjykatës Administrative të RMV-së (dërguar me postë më 12.4.2024) përmes autorizuesit, avokatit Benjamin Selimi nga Gostivari, kundër Agjencisë për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024.

3. Ky vendim hyn në fuqi me datë 26.4.2024, me kusht që SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, me kohë t'i përmbushë të gjitha detyrimet financiare dhe të tjera, të përcaktuara në pikën 2 të këtij Vendimi, ndaj Agjenci dhe për këtë të dorëzojë dëshmi në Agjenci.

Nëse radiotransmetuesi SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, nuk i përmbush detyrimet që përmban pika 2 e këtij vendimi brenda afatit të caktuar, mbetet në fuqi

Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim, PA1 nr.08-95, datë 7.9.2023 dhe Fatura për kompensim të lejes për radiotransmetim, nr.2024-100-0098 datë 19.3.2024 (ark nr.05-1287/1 datë 19.3.2024), dhënë në bazë të këtij Vendimi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, regjistrohet në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

5. Ky vendim botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në uebfaqen e Agjencisë.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë në seancën e 10-të mbajtur më 14.3.2024, në pajtim me Konkluzionin nr.0201-1235/2 datë 15.3.2024, miratoi Vendimin PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 67/24), për faktin se nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin e lejes për radiotransmetim në afatin e përcaktuar ligjor.

Me datë 20.3.2024 drejtuar Agjencisë nga SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, është dorëzuar Njoftimi me fletëpagesë për pagesën e kryer të faturës, nr 2024-100-0051 datë 11.1.2024 (ark.nr.0503-225/1 datë 11.1.2024), në shumë prej 32.084,00 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e katër) denarë, në të cilën ka deklaruar se plotësisht e ka përmbushur detyrimin për pagesën e kompensimit të lejes për radiotransmetim, sipas faturës së dorëzuar. Radiotransmetuesi me rastin e pagesës së kryer të kompensimit, në adresën elektronike të Agjencisë (contact@avmu.mk) ka dorëzuar dy Njoftime me datë 21.3.2024 (nr ynë ark.05-1347/1) dhe me datë 16.4.2024 me (nr ynë ark. 05-1347/2), në të cilin ai deklaroi se japin pëlqimin për kompensimin e shpenzimeve në vlerë të përgjithshme prej 6.574,00 denarë për publikimin e Vendimit për heqjen e lejes dhe Vendimin për anulimin e vendimit për heqjen e lejes në Gazetën Zyrtare të RMV-së, si dhe se do të iniciojnë kontest administrativ para gjykatës kompetente, për të cilin një kopje e padisë do t'i dorëzohet Agjencisë.

Për sa mësipër, nga ana e Sektorit për Financa dhe Logjistikë, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, i është dorëzuar Njoftim për pagesën e kryer të kompensimit të lejes nga SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, ark.nr.05-1757/1 datë 2.4.2024.

Ndërkohë, në adresën elektronike të Agjencisë (contact@avmu.mk) me datë 16.4.2024, nga ana e SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, është dorëzuar kopje e Padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të RMV-së përmes autorizuesit, avokatit Benjamin Selimi nga Gostivari, kundër Agjencisë për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89, datë 15.3.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023.

Në bazë të mundësisë ligjore që përmban neni 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe neni 42 paragrafi (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, më së voni deri me datë 26.4.2024, duhet t'i përmbushë këto detyrime financiare dhe të tjera, përkatësisht:

- të paguajë shpenzimet në vlerë prej 3.287,00 denarë me TVSH, për publikimin e Vendimit për heqjen e lejes për radiotransmetim PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024, në ("Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr.67/24)
- sipas faturës nr.3050-6849/27 datë 27.3.2024 (nr ynë ark.05-1528/1, datë 28.3.2024);

- të paguajë shpenzimet në vlerë prej 3.287,00 denarë me TVSH, për publikimin e këtij Vendimi për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes për radiotransmetim PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 në Gazetën Zyrtare të RMV-së;
- për tërheqjen e Padisë së paraqitur para Gjykatës Administrative të RMV-së (dërguar me postë më 12.4.2024), përmes autorizuesit, avokatit Benjamin Selimi nga Gostivari, kundër Agjencisë për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024.

Nëse transmetuesi SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar nuk i përmbush detyrimet në fjalë, në afatin e përcaktuar, atëherë mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.67/24) dhe Fatura për kompensimin e lejes për radiotransmetim, nr.2024-100-0098 datë 19.3.2024 (ark.nr.05-1287/1 datë 19.3.2024) e dhënë në bazë të këtij vendimi.

Duke pasur parasysh se SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, me pagesën e datës 20.3.2024, në shumë prej 32.084,00 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e katër) denarë, e ka përmbushur plotësisht detyrimin për pagesën e kompensimit për lejen për transmetim në radio, baza e mospagesës së kompensimit ka pushuar së ekzistuari në afatin e përcaktuar me ligj nga neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, në bazë të të cilit Këshilli i Agjencisë ka marrë vendim për heqjen e lejes për radiotransmetim.

Në pajtim me nenin 121 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe neni 42 paragrafit (1) nga Ligji i Kontesteve Administrative, Këshilli i Agjencisë miratoi Propozimin PA1 nr.08-140 datë 17.4.2024, të drejtorit të Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, për marrjen e vendimit për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023. dhe në seancën e 17-të mbajtur më 18.4.2024, me Konkluzion ark.nr. 02-1926/2 datë 18.4.2024, ka miratuar Vendim me të cilin është ofruar anulimi i Vendimit të Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0802-89 datë 15.3.2024 për heqjen e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr.08-95 datë 7.9.2023 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 67/24).

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Bazuar në sa më sipër është marrë Vendimi si në dispozitiv.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar ka të drejtë të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.